



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 31801 Prot.
11

Patos më 04.11.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.10.2025

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Erald Çepele
4. Lori Musaj
5. Artan Velçani
6. Armand Ahmetaj
7. Ertilla Myrtaj
8. Smerald Hazizaj
9. Elmira Rama
10. Renaldo Shpata
11. Vjollca Kasaj
12. Novrus Toska
13. Adile Alushaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar qytetarë!

I nderuar Kryetar i Bashkisë!

Të nderuar anëtar të këshillit!

Kjo është mbledhja e këshillit bashkiak e cila është thirrur në bazë të nenit 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 13 këshilltarë.

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
 - 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 15.10.2025.
 - 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 15.10.2025.
 - 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shtator 2025".
 - 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2025".
 - 6- Projekt-vendim "Për miratimin e planit i 5-vjeçar të strehimit 2025-2029".
 - 7- Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Patos në Këshillin e Qarkut Fier.
 - 8- Për miratimin e raportit "Për një zëvendësim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 "Për rishqyrtimin, miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme i ndryshuar.
 - 9- Propozim për fillimin e procedurave për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Dukas dhe anëtarit të kryesisë.
 - 10- Kërkesë nr. 2680 prot., datë 03.09.2025 për dhenie ndihme të menjëhershme.
- Armand Ahmetaj- Atëherë kemi ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr ndonjë pikë nga rendi i ditës?
- Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni kush është dakord me rendit e ditës?
- Miratohet me 13 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Loni Musaj
Smercol Hoxhaj
Reneida Shpota

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 31801 Prot.
112

Patos më 04 .11.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 15.10.2025

Armand Ahmetaj – Materialin e keni të gjithë, nëse keni ndonjë pyetje ose korrigjim?

Nese skemi miratohet dhe pika dy.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Smerodol Hoxhaj
Remelda Shyete

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 31804 Prot.
13

Patos më, 09 11.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 15.10.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 15.10.2025 u morën gjithsej 4 vendime nga nr. 63 deri në 66.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 63 i është përcjell Prefekturës dhe ka ardhur përgjigja se vendimi është në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj Mod
Smirak Haxho
Rensela Ibrata



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3108 / 3 Prot.

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shtator 2025”.

Mitjon Nikolla – Sektori i Shërbimit Social i paraqet këshillit të bashkisë Patos për miratim projektvendim nr. 65 datë 15.10.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Patos për muajin shtator 2025”.

Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Shtator 2025 gjithsej 16 familje me një fond prej 68,273 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit.

Lori Musaj - Kryetare e komisionit të ekonomisë- Përhëndetje të gjithëve! Komisioni ekonomisë u mbledh ditën e martë dhe pasi dëgjoi projektvendimin që relatoi ekzeutivi rezulton se ky projekt vendim është argumentuar në përputhje me bazë ligjore dhe e kemi miratuar pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin shtator 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj, Hod
Smeralda Hodja
Rumelba Shkete

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 31081 Prot.

3

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2025".

Mitjon Nikolla – Projektvendimi nr. 66 datë 15.10.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2025".

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Shtator 2025 gjithsej 19 familje me një fond prej 65,497 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

Me listën dhe me emrat jeni njohur në relacion. Përsa më sipër kerkoj miratimin.

Lori Musaj - Kryetare e komisionit të ekonomisë- Gjatë mbledhjes së komisionit është diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazë ligjore dhe e kemi miratuar pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë propozim?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin shtator 2025".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj
Smerold Kozaj
Refaela Xeba
Dhimitër Duka

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3126 / 3 Prot.

Patos më 04.11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00,, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e planit i 5-vjeçar të strehimit 2025-2029”.

Arben Shpërdheja- Në mbështetje të nenit 8, nenit 9 dhe nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 73, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar, urdhërit nr. 2625 prot., datë 28.08.2025 hartohet ky plan 5- vjeçar

Hartimi i këtij plan 5- vjeçar i strehimit social mbështetet në pesë pika.

- 1- Profilizimi i bashkisë Patos
- 2- Analiza e vlerësimit
- 3- Kushtet aktuale
- 4- Qëllimi
- 5- Objektivat

Referenca

Strategjia Kombëtare e Strehimit 2016-2025,
Udhëzimi për Strehimin Social në nivel Bashkie,
Regjistri i Gjendjes Civile, viti 2025
Ligji nr. 22/ 2018 “Për strehimin Social”
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Profilizimi i bashkisë

Bashkia Patos ka një popullsi prej 42,196 banorë, pjesë e 13,964 familjeve. Ajo është e organizuar në tre njësi administrative, Njësia Administrative Patos, Njësia Administrative Ruzhdie dhe Njësia Administrative Zharrëz. Ka një shpërndarje të pabarabartë të popullsisë në territorin e tre njësive administrative të bashkisë Patos. Specifikisht:

Njësiti			
Administrative	Qytetet dhe fshatrat	Popullsia	Përqindja
	7 fshatra		
Patos		30,646	72.6%
	6 fshatra		
Zharrëz		8,810	20%
	5 fshatra		
Ruzhdie		3,241	7.5%

Të dhënat e Censurit për vitin 2023 janë 24,199 banorë dhe tregojnë që numri i popullsisë që jeton realisht në territorin e bashkisë është më i ulët, për shkak të migrimit dhe emigrimit.

Duke mbajtur në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, por edhe situatën e grupeve në nevojë në territorin e saj, e konsideron të rëndësishëm planifikimin e strehimit.

Në përputhje me vlerësimin e nevojave për strehim në territorin e bashkisë të identifikuarra përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, diskutimeve me stafin dhe aktorët e tjerë, bashkia Patos përcaktoi dhe adreson përmes masave konkrete prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të strehimit social, pjesë e Plani 5- vjeçar 2025-2029.

1- Analiza e vlerësimit

Plani 5-vjeçar i Strehim 2025-2029 do të shoqërohet me një Plan Veprimi të kostuar, i cili përkthehet në masa konkrete të angazhimit të marrë për të garantuar dhe ofruar strehimin e përbalueshëm me cilësi për të gjitha shtresat në nevojë. Gjithashtu, ky dokument hedh piketat për investime të qëndrueshme dhe afatgjata në sektorin e strehimit.

Analiza e situatës mbështetet në shqyrtimin e dokumentave, analizimin e të dhënave të grumbulluara ndër vite nga bashkia, aplikantëve dhe përfituesve sipas programeve të strehimit social. Analiza e situatës hedh dritë mbi kërkesën dhe ofertën për strehim social në nivel vendor, si dhe mbi sistemin e pikëzimit të Vlerësimi hodhi dritë mbi karakteristikat e familjeve përfituese, kapacitetet e njësisë vendore për sigurimin e strehimit social, shpërndarjen e buxhetit për strehim social, transparencën dhe sigurinë e informacionit, si dhe marrëdhënien mes qeverisë vendore e asaj qendrore.

Sfida kryesore është njohja e qartë e ofertës dhe kërkesës për strehim social.

Qeveria ka ngritur disa programe sociale strehimi. Bazuar në kërkesat e qytetarëve aplikant, në bashkinë Patos interes të shtuar kanë banesat sociale me qira, banesat me kosto të ulët dhe rikonstrukcion i banesave për familjet në nevojë. Përfituesit e programeve sociale të strehimit janë kryesisht familje që përmbushin njërin prej kriterëve të mëposhtëm: nuk kanë në pronësi një banesë, zotërojnë sipërfaqe banimi në norëm më të ulët se standardi i përcaktuar, nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar strehimin në tregun e lirë, ose janë pjesë e një kategorie sociale të veçantë që e bënë të domosdoshëm përfshirjen e tyre. Përzgjedhja e përfituesve përcaktohet në bazë të sistemit të pikëzimit të miratuar me VKB sipas legjislacionit në fuqi. Sistemi i vlerësimit me pikë është krijuar për t'u dhënë përparësi grupeve që ndodhen në pozita të pafavorshme. Pronat e bashkisë Patos nuk janë të regjistruara në mënyrë përfundimtare. Mungojnë shoqëritë e ndërtimit.

Ky është plani i dytë 5-vjeçar për bashkinë Patos.

Nisur nga objektivat e planit 5-vjeçar 2019-2024 realizimet e arritura ishin të kënaqshme:

Përfundimisht me planin e strehimit 2019-2024 u bë e mundur rikonstrukcioni i 3 objekteve ku u përfituan 59 apartamente me qira me bashkëfinancim, si dhe rikonstrukcioni i 33 banesave individuale në total me bashkëfinancim dhe me fondet nga vetë bashkia për familjet në nevojë. Përfitues direkt ishin nga të gjitha grupet shoqërore në një numër total prej 245 frymë. Dhe këto janë të ndara ndër vite.

2- Kushtet aktuale

Është paraqitur në mënyrë tabelare për vitin 2024 - 2025 kërkesit dhe përfituesit sipas programeve të strehimit. Janë paraqitur gjithashtu në mënyrë tabelare dhe objektet e transferuara për strehim bashkisë Patos sipas vkm 443 të inventarit të pronave.

3- QËLLIMI

Qëllimi i Planit të Strehimit Social është përmirësimi i kushteve të jetesës së rreth 230 familjeve në bashkinë Patos me të ardhura të ulëta dhe të mesme, që nuk mund të përballojnë një shtëpi në tregun e lirë (duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara, që vuajnë nga përjashtimi social), përmes ofrimit të alternativave për strehim të gatshëm, të arritshëm, të përbalueshëm dhe të përshtatshëm. Parime udhëzuese kryesore në një sektor strehimi social funksional janë: gatishmëria, përbalueshmëria dhe arritshmëria.

Gatishmëria Në kontekstin e strehimit social është qartazi e rëndësishme që banesat t'u jepen përfituesve të synuar. Gatishmëria e banesave është një çështje që lidhet në mënyrë specifike me vendndodhjen.

Përballueshmëria. Strehimi i përballueshëm me cilësi të mirë, pasja e një shtëpie me kosto të përballueshme siguron stabilitet, pozitiv për familjet përfituese. Është e rëndësishme që të shqyrtohet përballueshmëria e kësteve mujore (për banesat me kosto të ulët) me kalimin e kohës, por edhe kostot e administrimit dhe mirëmbajtjes së banesës.

Arritshmëria. Në strehimin social arritshmëri quhet tërësia e rregullave dhe rregulloreve që u mundësojnë familjeve të kualifikohen dhe të përzgjidhen për strehim social. Identifikimi i grupeve të nënsynuara dhe vendosja e prioriteteve, si edhe vendosja e kuotave për grupet specifike të synuara, mund të rrisin arritshmërinë.

5 -OBJEKTIVAT

Evidentimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe në bashkini

Vlerësimi i nevojave për strehim në bashkinë Patos, fokusimi i grupeve në pozita të pafavorizuara.

Mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim në bashkinë Patos.

Reduktimi i familjeve të pastreha

Për vitin 2025 – 2029 synohet rikonstrukcion banese për 60 familje në nevojë nga të gjitha grupet shoqërore, si dhe rikonstrukcionin e ish kaponit në lagjen 29 Marsi. Do të krijohet një fond strehimi.

Vjollca Kasaj- Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale u mbledh ditën e mërkurë për të shqyrtuar planin e 5-vjeçar social të hartuar nga Bashkia Patos. Me diskutimet e bëra komisioni vendosi me tre vota ta miratoi këtë plan por një sqarim desha unë si person nga ana e kryetarit nëse për banesat të cilat kanë kaluar me VKM si pronësi e bashkisë pra kanë qenë pronësi e ministrisë dhe kanë kaluar pronësia juaja, për qytetarët që kanë aplikuar me dokumentacion dhe kanë vite mbi 40 vite që jetojnë ato banesa si do vazhdoi procedura për këto domethënë jashtë programeve që kanë bashkia për grupet të interesit grupet në nevojë apo familjet në vështirësi apo familjet rome dhe egjiptiane për të ndihmuar si do veprohet me këto familje të cilat kanë aplikuar kanë çuar dokumentacion për hipotekim të banesave të tyre dhe kanë vite nuk janë strehuar nga bashkia por janë strehuar nga ndërmarrjet aktuale atëherë të naftës? Si do veprohet?

Kryetari i Bashkisë- Për pjesën se çfarë ka bërë bashkia që i ka bërë me certifikatë gjithë ajo pjesë ka kaluar ka vazhduar procedurat e tjera për zgjidhje por janë në proces, nuk është se varet nga bashkia.

Vjollca Kasaj- Komisioni e kemi kaluar Planin e Stresimit jemi dakord me bazën ligjore ku është mbështetur dhe e kemi kaluar me tre vota pro.

Smerald Hazizaj- mar shkas këtu duke qënë që kryetar i bashkisë është prezent, ka disa kohë që banesat sociale në bashkinë e Patosit që janë në ndërtim janë goxha të konsiderueshme dhe jap përgëzime sepse jemi të gjithë bashkë pjesë e këtij fakti.

Ajo çfarë vëreh unë si banor i lagjes Mustafa Matohiti shikoj që në lagjen Mustafa Matohiti që është një nga lagjet më të vjetra të qytetit dhe ka në këndvështrimin tim gjithmonë kjo ka nevojë të veçantë për strehim dhe këtu shpresoj dhe uroj që 2025-2029 pse jo të jetë një fokus shumë i veçantë në lagjen Mustafa Matohiti, Rerësi dhe Margëlliçi Kryetar unë e mbështes e kam miratuar por prapë vet por për shkak të një kleçke që lagjen e Mustafa Matohiti, Rerësi dhe Margëlliçi nuk ka kaluar azhurnimi kjo jo për faj të banorëve unë uroj dhe shpresoj që 2005-2029 kjo mos të jetë një lloj pengese ne ta tejkalojmë këtë dhe ata banorë me të drejtën e tyre besoj se meritojnë një

vëmendje të tillë nga bashkia për shkak sepse lagja Mustafa Matohiti siç e thashë është jo vetëm një nga lagjet më të vjetra po për fatin e keq unë duhet ta pranoj këtu kanë ndoshta migrimin më të lart Unë nuk dua që në 2027 e afërt që të shkojmë në ato lagje dhe të trokasim nëpër dyer dhe ti gjejmë bosh.

Ky plan 2025-2029 ka miratimin tim, unë uroj dhe shpresoj që të jete në vëmendje për lagjen Mustafa Matohiti, Rerësi dhe Margëlliçi .

Erald Çepele - kam një pyetje lidhur me politikat sociale të bashkisë Patosit për pesëvjeçarin e ardhshëm lidhur me çiftet e reja siç e ka bashkia e Tiranës që ka programin kredit e buta deri tani janë 3600 kërkesa dhe 1200 kanë përfituar, bashkia Fierit ka programin e strehimit social, çfarë është parashikuar lidhur me çiftet e reja që të cilët duan të blejnë një apartamentet dhe ta ndërtojnë jetën këtu Patos lidhur me ndonjë kredi të butë ose subvencionimi të kredisë.

Kryetari i Bashkisë-në fakt deri sot në dijeninë time asnjë çift nuk ka kërkuar strehim në bashkinë e Patosit, madje ne vitin e kaluar ne kemi bërë thirrje për të gjithë qytetarët që bëjnë kërkesë për banesën sociale apo për të marrë shtëpi duke pasur parasysh aplikimi që mund të bëhen në ministri për ndërtimin e pallatit që mund të merret pastaj me kredit butë kërkesat kanë qenë shumë herë për mos të thënë fare shumë të vogla që të justifikohet aplikimi në ministrinë përkatëse për ndërtimin e pallatit domethënë jemi në atë pikë aktualisht nga kërkesa që kemi që nuk justifikojmë dot pasi kërkesat janë të jashtëzakonisht shumë të ulta për shtëpi me kredit butë. Që dikush të krijoj një plan minimalisht duhet të nisësh nga disa kërkesa

Plani pesë vjeçar ecën me parashikim në qoftë se nuk kemi asnjë kërkesë si mund ta fusim në planin pesë vjeçar?

Madje njoftimin e kemi bërë dhe në rrjetet sociale, tek faqja e bashkisë madje dhe te faqja ime aplikoni për këtë gjë, kërkesat kanë qënë zero. Nëse do të jetoje në Patos se për fat të keq do ta them këtë gjë po të dalësh në dark do të shohësh që ka shumë shtëpi bosh. Tani ne do të ndërtojmë përsëri shtëpi të tjera që ti lëm dhe ato bosh. Është kërkesë ofertë. Nuk mund të fusim një gjë në plan kur praktikisht për momentin nuk ekziston dhe nuk mund të bëjmë një parashikim kur për kaq kohë kërkesat kanë qënë zero. Nëse për 2 vjet kërkesat kanë qënë zero ne nuk mund të themi që për pesë vjet këto do rriten.

Armand Ahmetaj- Plani mund të ndryshoj- nëse kemi kërkesa këtu jemi

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e planit i 5-vjeçar të strehimit 2025-2029”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.


SEKRETARE

Refaela Xeba



Lori Musaj Nag.
Smerol Hoxh
Rendela Shyete

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3189/19 Prot.

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Patos në Këshillin e Qarkut Fier.

Armand Ahmetaj –është një pikë që ne nisëm ta shqyrtonim në mbledhjen e kaluar por e shtytëm për shkak të mungesës së këshilltarit që u propozua për këtë ndaj rikthehet sërish për shqyrtim në këshill. propozimi duhet të vij nga këshilli me shkrim nuk kemi asnjë.

Artan Velçani- Besoj herën e kaluar unë falenderoj dhe këshilltarët që propozimin tim për kalimin e kësaj pike në mbledhjen e ardhshme u kuptua dhe ne jemi në të njëjtat kushte për arsye që ne i dimë të të gjithë këtu, është bërë një ndarje qysh në konstituimin e këtij këshilli dhe për shkak të rregullit të gjinisë vendi vakant për shkak të të ndjerës këshilltare të zëvendësohet nga znj. Adile Alushaj dhe propozimi jonë dhe është që të kaloj në atë pozicion për të zëvendësuar anëtarin në këshillin e Qarkut.

Armand Ahmetaj – Nëse nuk kemi propozim tjetër propozoj të kalojmë në votim emrin e propozuar nga kryetari i grupit të Partisë Socialiste, zëvendësimin e të ndjerës me znj. Adile Alushaj.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Lori Musaj
Smerdet Hoxhoxhi
Rendel Shyete

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2774 / 14 Prot.

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Për miratimin e raportit “Për një zëvendësim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “Për rishqyrtimin, miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme i ndryshuar.

Kemi të bëjmë me të njëjtin rast pra me vakanën e krijuar për shkak të humbjes së jetës të këshilltares znj. Enkelejda Ajazi. E gjithë procedura bazohet në nenin 54 shkronja i, nenit 75 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pra zëvendësimi në të dyja rastet në komisionin e Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale dhe komisioni Arsimit Shëndetësi Rini dhe Sporte e ndjera znj. Enkelejda Ajazi të zëvendësohet nga znj. Adile Alushaj.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

Albiona Lamaj- Një këkresë duke qënë se për të dy komisionet ne bëjmë shumicën e anëtarëve që jemi prezent do të kërkoja që pas mbledhjes së këshillit anëtarët të komisionit të qëndrojnë këtu që të diskutojmë edhe njëherë konstituimin e komisioneve.

Armand Ahmetaj- Të gjithë anëtarëve e të dy komisioneve siç e kërkoj edhe një anëtare që është në të dyja komisionet Alba mund të mblidhen dhe mbasi të kenë mbaruar mbledhjen të njoftojnë këshillin me shkresë përkatëse për zgjedhjen që kanë bërë kryetar zëvendëskryetar në këtë rast.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Smereta Horizog
Rendita Shkurtaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3110/Prot.

3

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Propozim për fillimin e procedurave për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Dukas dhe anëtarit të kryesisë.

Armand Ahmetaj – Kjo procedurë ka nisur për shkak se dy anëtarë të këshillit të fshatit kanë humbur jetën Luan Kripa dhe Ilmi Myftaraj.

Procedura bazohet në Rregulloren për Funksionimin e Strukturave Komunitare konkretisht neni 39 dhe 40. Kjo rregullore është miratuar me VKB 45 datë 25.11.2020. Do doja t'jua lexoja.

Komisionit për Administrimin e Zgjedhjeve për strukturat komunitare përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të cilët janë Sekretari i Këshillit Bashkiak, zëvendëskryetari i Bashkisë, drejtuesi i drejtorise/sektorit juridik, drejtuesi i njësisë për fuqizimin dhe zhvillimin e komuniteteve, juristi i sekretariatit të Këshillit Bashkiak apo një jurist i pavarur i caktuar nga Këshili Bashkiak. Bëhet fjale për strukturat komunitare në rastet e bashkive të mëdha se bashkia jonë është e vogël dhe nuk kemi struktura komunitare. Neni 40 përcakton qartë rregullat për komisionin e strukturave të fshatit për monitorimin e zgjedhjeve.

Procesi i zgjedhjes së Kryesive dhe Kryetarëve të Fshatrave dhe i Këshillave dhe Ndërlidhësave Komunitarë mbikëqyret nga Këshilli Bashkiak.

Këshilli me vendim ngre Komisionin Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve të strukturave komunitare në nivel Bashkie. Komisioni ka pesë (5) anëtarë dhe përbëhet nga: Kryetari i Këshillit apo i autorizuari prej tij, kryetari i komisionit për strukturat komunitare, një këshilltar nga opozita më e madhe në Këshillin Bashkiak, zëvendëskryetari i bashkisë dhe një nga administratorët e NjA të caktuar nga Kryetari i Bashkisë. Komisioni i paraqet Këshillit Bashkiak raportin e monitorimit të zgjedhjeve, jo më vonë se 10 apo 15 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve në secilin fshat apo lagje. Në rastin e Lgjes dukas rregullorja detyron caktimin e dy anëtarëve të këshillit dhe sekretari i këshillit i cili është i detyruar sipas rregullores të jetë në krye të këtij komisioni ndaj dhe ne duhet të marrim një vendim për anëtarët e këshillit se të tjerat i ka përcaktuar rregullorja. Unë propozoj që për lagjen Dukas meqënëse se e preferuar që për këtë komision të monitorimit të jetë këshilltari që është banues në këtë lagje dhe në këtë rast kemi Ertilla Myftaraj ndërsa nga opozita do doja të propozoja z. Eduart, Znj. Adile nuk është se është në Aranitas dhe bën pjesë në Kuqar. Ose mund të jetë dhe Adile nuk është problem fare e marrim ne vendimin këtu. Keni ndonjë propozim tjetër veç kësaj që sapo thashë?

Albiona Lamaj- doja vetëm duke qenë se për këta të dy anëtarët ne kemi edhe një përfaqësues familjare këshilltare këtu doja të shprehja këtu në emër të të gjithë këshilltarëve mirënjohje për çdo kontribut që kanë dhënë sepse ata kanë qenë dhe zëri jonë dhe kanë bërë detyrën edhe më shumë se detyrën pranë komunitetit dhe me çdo qytetarë faleminderit dhe mirënjohje në emër të këshillit bashkiak Patos.

Armand Ahmetaj- Jemi duke marrë masa që të zhvillohet një ceremoni zyrtare për këtë fakt.

Armand Ahmetaj – Atëherë nga Këshilli për monitorimin e zgjedhjeve të fshatit Dukas propozoj të jetë znj. Ertilla Myrtaj dhe znj. Adile Alushaj dhe sekretari këshillit bashkiak

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2680 Prot.
2

Patos më 04 11.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2025 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Kërkesë nr. 2680 prot., datë 03.09.2025 për dhenie ndihme të menjëhershme.

Albiona Lamaj- Zv Kryetare e Komisionit të Arsimit Shëndetësisë Rinise dhe Sportet
Komisioni i Arsimit dhe Shëndetësisë është mbledhur ditën e mërkurë ku ka shqyrtuar rastin dhe rasti në fjalë dhe bëhet fjalë për zonjën Liri Velmishi dhe ne ndodhemi në muajin tetor muajin tetori rozë të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit dhe zonja që është është shprehur kërkesa për ndihmë të menjëhershme vuan nga sëmundja e kancerit të gjirit stadi i avancuar kështu që do donim shumë që këto muaj tetor ky ndërgjegjësimi të vlejë që të mos kemi raste të tilla dhe prandaj prandaj bëhet edhe ndërgjegjësimi parandalimi që sa më pak raste të grave që vuajnë nga keto sëmundje, komisioni është mbledhur dhe si në në çdo rast të tjera duke folur me pjesën ekzekutiv të jepet ndihma maksimale siç kemi dhënë në rastet e tjera faleminderit.

Lori Musaj Kryetare e komisionit të Ekonomisë- Gjatë mbledhjes të komisionit të Ekonomisë ne kemi diskutuar mbi rastin e zonjës dhe kemi vlerësuar dokumentacionin dhe situatën shëndetësore dhe sociale të saj dhe kemi vendosur të propozojmë miratimin e një ndihme financiare në vlerën 150 mijë lekë i cili do të jepet nga fundi rezervë i bashkisë.

Ky vendim është një shprehje e ndjeshmërisë njerëzore dhe solidariteti që dhe administrata jonë lokale tregon ndaj qytetarëve në nevojë ndihma sadopak modeste që mund të jetë synon të lehtësojë dhimbjen dhe vështirësinë e saj të moment të vështirë faleminderit.

Armand Ahmetaj – Rasti është terminal shuma e propozuar për ndihmë është 150 mijë leke të reja.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Lori Musaj
Smerpol
Rendita Sheta

KRYETAR
Armand Ahmetaj